



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-03 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, si dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-23769/24 dt. 13.02.2024, të pronarit Kastriot Kryeziu nga Prishtina, rr. “Gavril Dara”, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me dt. 10.07.2024 merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Kastriot Kryeziu nga fshati Bubavec, Malishevë, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-23769/24 dt. 13.02.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet P+1, në kuadër të bllokut ndërtimor “L-22” të tërësisë hapësinore “L” të Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Perëndim”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 205-6 ZK. Çagllavicë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Perëndim”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal nr. 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, ku sipas këtij plani ky lokacion përfshihet në ngastrën e ndërtimit “L-22-28”, dhe sipas këtij plani kjo zonë ka destinim “Rezidencial- banim individual”.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit- parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 205-6 ZK Çagllavicë, me S=461 m², me pronar Kastriot Kryeziu, “Arë e Klasës 4”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë ekzistuese, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese “Nokshiq”, njëherit edhe e planifikuar, gjegjësisht përmes parcelës kadastrale 205-1 ZK Çagllavicë;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore.

hapësirës dhe realizimin - ndërtimin shtëpisë individuale banimore-shtëpisë familjare, në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re- Zona Perëndim", në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhite i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin i lokacionit – "Situacioni", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcela kadastrale e trajtuar për realizimin e ndërtesës- shtëpisë individuale të banimit, konkretisht parcela kadastrale e përfshirë- e trajtuar brenda vijës rregulluese, është:
 - nr. 205-6, me $S=423.51 \text{ m}^2$;**Sipërfaqe totale $S=423.51 \text{ m}^2$;**
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Rregullues Prishtina e Re- Zona Perëndim, të jetë për banim individual, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhite maksimal i lejuar, sipas PRrU-së, është P+2, ndërsa numri i etazheve nëntokësore nuk kufizohet, kurse etazhite i propozuar dhe i miratuar është P+1;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë- gabarit të përdhësës, sipas PRrU-së, është max 0.4 (40%);
 - $S = 423.51 \times 0.4 = 169.404 \text{ m}^2$. (e lejuar)
 - $S = 162.3 \text{ m}^2$ e propozuar
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për vendosjen e ndërtesave në bazë- gabarit të bodrumit, sipas PRrU-së, është max. 60%;
 - $S = 423.51 \times 0.6 = 254.106 \text{ m}^2$.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, sipas Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015, është min 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%;
 - $S = 423.51 \times 0.25 = 105.8775 \text{ m}^2$
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues, është maksimum 450m². Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokësuteren, dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrome; e propozuar Sipërfaqe totale bruto: **328.1 m²**.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga rruga / niveli i terrenit, të jetë max. 0.45m²;
- Qasja në parcelë të jetë nga rruga ekzistuese, të paraqitur në Planin "Situacioni";
- Distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m, për distancat më të vogla të propozuara palët obligohen të prezantojnë pëlqimet përkatëse dhe të mos vendosin hapje të kthinave primare në ato balle, si psh.:dhomë gjumi dhe dhomë e ditës;
- Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj., nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0m` nga parcela fqinje;
- Rrethojat kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përskaaj rrugës ka lartësi prej max 1.5m ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0m;

- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 40% për gjelbërim, sipas Vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-185481 dt. 14.08.2015;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. **Ndarja / Parcelimi** i parcelës kadastrale nr. 205-6 ZK. Çagllavicë, do të bëhet në vijë rregulluese-parcelës ndërtimore, bazuar në Planin Rregullues "Prishtina e Re- Zona Perëndim", Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manuali i ndarjes së parcelës, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës së lartcekur, sipas Planit të situacionit- "zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes së parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të aplikuesve/pronarëve/investitorit, duke u bazuar në Plani i situacionit- "zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes së parcelave, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin- adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"- Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. **Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;

- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme për hartimin e Projektit Kryesor, për nevojat e realizimit të ndërtimit, i cili do të jetë konform Kodit të Ndërtimit dhe rregulloreve teknike në fuqi;

VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore- meqenëse parcela kadastrale nr. 205-6 Çagllavicë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës- tokës “Bujqësore”, me klasë të kualitetit “Arë e Klasës 4 ”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, dhe parcelës ndërtimore të caktuar me Planin Rregullues të “Prishtina e re-Zona Perëndim” dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, me S=423.51 m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, andaj, kjo Drejtori jep PËLQIM për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Kjo pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore, bazuar në pëlqimin e dhënë në këtë paragraf.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore- këtë Vendim, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori (kopje);
- Autorizimin për përfaqësim;
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve.

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për Dhënien e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifën për Rregullimin e Infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, “Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi taksën administrative

XI. për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01nr.434/01-227572/23 dt.01.12.2023 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas

afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. Vlefshmëria e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronari Kastriot Kryeziu nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-23769/24 dt. 13.02.2024, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit në lokacionin e përshkruar në paragrafin i të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë dhe kopjen e planit për parcelën kadastrale nr. 205-6 ZK Çagllavicë;
- Foto të lokacionit;
- Inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale nr.205-6 ZK Çagllavicë, i punuar nga gjeodeti i licencuar Dafina Tmava Gashi me nr. të licensës 116;
- Manualin për ndarje të parcelës kadastrale, të punuar nga gjeodeti i licencuar Dafina Tmava Mehmeti me nr. të licensës 116;
- Certifikata e biznesit NSH "MIK" me nr. Unik identifikues të biznesit 810720351.
- Pëlqim me nr. LRP 158/2024, pëlqim ndërtimi në distancë 2 metra nga parcela 00205-5 me pronar Rexehp Bajrami
- Pëlqim me nr.LRP 229/2024, pëlqim ndërtimi në distance 1 metër nga parcela 00201-14 me pronar Korab Berisha.
- Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re- Zona Perëndimore me reference 04-350/01-195928/23 dhe plotesim lende 04-070/01-209203/23 dt 20.10.2023.
- Certifikatë e biznesit e kompanisë projektuese "PROPAS" me numër unik identifikues 811378620
- Kopje e ID e Kastriot Kryeziut
- Projektin ideor/ konceptual

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-23769/24 dt. 13.02.2024, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se parcela kadastrale nr. 205-6 ZK. Çagllavicë, shtrihet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re- Zona Perëndim", i miratuar Vendimin e Kuvendit Komunal nr. 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, ku sipas këtij plani ky lokacion përfshihet në ngastrën e ndërtimit "L-22-28", dhe sipas këtij plani kjo zonë ka destinim "Rezidencial- banim individual".

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo Drejtoria, me datë 19.03.2024 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m', si dhe në ueb faqen e Komunës së Prishtinës, për të njoftuar publikun me synimin e aplikuesit/pronarit, për ndërtim, si dhe i njëjti, sipas rregullativës ligjore në fuqi, është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 23.03.2024, si dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në Drejtorinë e Urbanizmit të

zone në lidhje me ndërtimin e propozuar.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit- ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit në rrugën e planifikuar sipas planit rregullues, si dhe organizimin e rrugëve të brendshme dhe vendparkimeve, në kuadër të kompleksit, dhe është konstatuar si në vijim: “Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Kastriot Kryeziu, në Çagllavicë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-23769/24 dt.13.02.2024, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Nokshiqi”, e cila rrugë është e paraparë edhe me planin rregullues “Prishtina e Re Zona Perëndim”, si e tillë duhet të prezantohet situacioni i rrugës sipas planit rregullues Prishtina e re Zona Perëndim. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes, si dhe të aplikohen rrezet e lagesave te kyçjes ne raport me rrugën e planifikuar.”

Z. Kryeziu ka sjellur si pjesë të lëndës pëlqimin me numër rendor LRP.158/ 2024 për ndërtim me distancë deri 2 m nga parcela 00205-5 dhe pëlqimin me numër rendor 229/2024 për ndërtim me distancë 1m nga parcela 00201-14.

Andaj, si konkludim përfundimtar, pas konstatimeve të lartë shënuara, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, projektit konceptual, dhe me që gjatë procedurës së njoftimit publik nuk është pranuar ndonjë ankesë apo sugjerim, ka konstatuar se, kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret e Planit Rregullues, për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit - "Situacioni", "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01" të punuar nga kjo Drejtori; si dhe "Propozim për ndarje të parcelës kadastrale" të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit; në dosje të lëndës; kësaj Drejtorie; dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit; dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-23769/24 DT. 10.07.2024

Zyrtari:
Shkurte Dalipi



Faqe 6 prej 6

Komuna e Prishtinës - Drejtorja e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242; e-mail: urbanizmi@prishtine.gov.net





Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosova
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 205-6

Zona kadastrale / Katastarska zona: ÇAGLLAVICË


Numri i lëndës / Broj predmeta: 362/2023

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 250

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis


Nr.	Y	X
1	7511920.097	4721178.124
2	7511919.057	4721158.614
3	7511896.769	4721159.255
4	7511895.878	4721159.301
5	7511896.709	4721179.280
6	7511897.457	4721179.243
7	7511903.619	4721178.939
8	7511895.944	4721160.896
9	7511919.142	4721160.212



Rilevoi / Snimio: DAFINA TMAVA-GASHI
 (emri dhe mbiemri i gjedetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanje)



Aprovoi / Usvojio: _____
 (emri dhe mbiemri i përsosnit zyrtar/ ime i prezime shërbëtorit)



201-15

201-14

P+1

23.24m

201-8

B+P+1+NK

205-9

20.00m

PARCELI KADASTRAL

P+1

Parcela: 205-6

19.52m

PARCELI KADASTRAL

205-1

23.31m

Rr. "NOKSHIQ"

VIA REGULATIVE

205-8

P+1

205-24

P+1

LEGJENDA

LIJORI PARCELES KADASTRALE	592.8
OBJEKTI PER LIE NDERIMI	
KUOTA E NATUR	
VIA RREGULLIMORE	
CABARIT I OBJEKTIT	
RINDE	
OBJEKTI PER RRETHI	
VIA RREGULLATIVE	

NR.1 Promar: KASTRIOT KRVEZIU	Parcela	205-6	ISHP	0.4	Sipërfaqja e parcelës	461m ²	Ecatshifet	P+1
NR.1 Sipërfaqja e përdhënës	162.3m ²	ISHP	461 X 0.4 = 184.4 m ²	Ecatshifet	max P+2			
NR.1 Sipërfaqja e kalli 1	165.8m ²	ISFN	MAX 450°					
Total sipërfaqja e burit	328.1m ²	ISGJ	25%					

SHTËPI BANIMI INDIVIDUALE P+1

Vendi i ndërtimit:	Parcela:
Rr. "NOKSHIQ"	205-6
Prishinë	
Investitori:	KASTRIOT KRVEZIU
S=m ²	KORRIK 2023
	Prishinë

FAZA E PROJEKTI - ARKITEKTURA

Prësa e projektit:	Projektores:
SITUACIONI TËNGJESHTE	PROP/5
	architectures
Perpjesa: 1:200	Faqja: 1

